

SHENIME SHPJEGUESE; Per periudhen 01 Janar deri me 31 Dhjetor 2023.

Ne kete aneks paraqiten informacionet shpjeguese ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare te njesise ekonomike Big Fieri sh.p.k.

Njesia ekonomike Big Fieri sh.p.k e krijuar me date 21.04.2014 ushtron aktivitetin e saj ne fushen Supermarketeve FIER Lagjja 1 Maji, Rruga Jani Bakalli, Pallati i Dytë, Dyqani i Parë, prane Drejtorisë së Shëndetit Publik. Per periudhen 01 Janar 2023 deri me 31 Dhjetor 2023 jane pergatitur dhe paraqitur paketa e plote e pasqyrave financiare, te cilat japin pamjen te vertete dhe te drejte te pozicionit financiare, performances financiare dhe fluksit te parase gjate kesaj periudhe.

Pergatitja dhe paraqitja e tyre, e cila eshte pergjegjesi e Drejtimit te subjektit, eshte realizuar mbeshtetur ne Ligjin nr 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit(KKK). Gjuha e perdorur eshte gjuha shqipe. Monedha e perdorur eshte monedha Leke. Rrumbullakime te vlerave nuk ka. Ngjarjet dhe trasaksionet jane evidentuar gjate gjithë periudhes ushtrimore ne perputhje me SKK nr 1 Kuadri i pergjithshem per pergatitjen e pasqyrave financiare dhe SKK nr 2 Paraqitja e pasqyrave financiare si dhe cdo standard tjeter kombetar ne perputhje me natyren e ngjarjeve apo transaksioneve te cilat ne menyre te hollesishme do te jepen ne vijim te informacioneve shpjeguese.

❖ Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren BILANC.

Paraqitja e kesaj pasqyre eshte mbeshtur ne paketen e plote te standardeve te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit. Ne vijim do te jepen informacionet shpjeguese per zerat perberes te saj.

I. Informacione Shpjeguese per AKTIVET.

Totali i aktiveve te paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **32,473,040 leke** detajimi nepermjet informacioneve shpjeguese i te ciles paraqitet si vijon;

✚ Informacione shpjeguese te AKTIVE AFATSHKURTRA

Aktiveve afatshkurtra jane paraqitur ne vleren **31,063,404 leke** te cilat jane te perbera nga;

1.Aktive monetare 6,243,209 leke. Ky ze eshte paraqitur ne pasqyre duke u mbeshtetur edhe ne SKK nr 12 paraqet tepricen e llogarise Arka dhe tepricen e llogarise banke, ne monedhen lek ne date 31.12.2023.

2.Te drejta te arketueshme te cilat jane paraqitur ne vleren **4,824,932 leke** dhe eshte e perbere nga;

Zeri, Nga aktiviteti i shfrytëzimit ne vleren **4,824,932 leke**, i cili eshte evidentuar edhe ne perputhje me SKK nr 3 ne te cilen përfshihen të gjitha të drejtat e krijuara gjate periudhes ushtrimore ndaj klientave për shitjen e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm, te paraqitura me vleren neto te realizueshme.

Zeri, Kërkesa ndaj tatim taksave ne vleren **0 leke**,përfshihen te gjitha te drejtat e njësisë ndaj të tretëve,të krijur gjatë periudhes ushtrimore i cili eshte i përbër prej

Tatim fitimi 444 0

3.Inventari i paraqitur ne vleren **19,995,263 leke**, i cili eshte i perbere prej;

Zeri Mallra ne vleren **19,995,263 leke te cilat** jane njohur dhe vleresuar ne perputhje me SKK nr 4 *Inventaret*. Kostoja e inventarit eshte vleresuar me metoden e kostos mesatare te ponderuar.

Mallrat e blera gjate periudhes ushtrimore jane **121,887,529.7 leke** dhe kosto e mallrave te shitur e cila eshte pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte **119,543,891 leke**.

✚ Informacione shpjeguese te AKTIVET AFATGJATA

Aktivt afatgjata jane paraqitur ne Vleren Kontabel Neto **1,409,636 leke**. Ato jane evidentuar edhe ne perputhje me SKK nr 5 Aktivt afatgjata materiale dhe aktivt afatgjata jomateriale. Paraqitja e tyre eshte bere nepermjet politikës kontabel Metoda e Kostos. Perberja e ketij zeri paraqitet si vijon;

1.Aktive afatgjata materiale jane ne vleren **1,409,636 leke** dhe eshte i perbere nga zeri

Impjante dhe maknieri ne vleren **922,255 leke**.

Ne tabelen e amortizimit perbejne zerat e Makineri dhe Pajisje Energjitike

Metoda e perzgjedhur per amortizimin eshte metoda mbi vleren e mbetur , dhe eshte njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per periudhen ushtrimore ne vleren **221,988 leke**.

Pajisje kompjuterike, pajisje zyre ne vleren **487,381 leke**.

Ne tabelen e amortizimit perbejne zerin PAJISJE KOMPJUTERIKE DHE INFORMATIKE. Metoda e perzgjedhur per amortizimin eshte metoda mbi vleren e mbetur , dhe eshte njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per periudhen ushtrimore ne vleren **125,013 leke**

Ne te jane te perfshire elementet e meposhtem;

Nr. Llogarie	Emertimi i Llogarise	Monedha	Debi	Kredi
2181	Impiante dhe makineri	LEK	922,225	
2188	Pajisje Kompjuterike ,pajisje zyre	LEK	487,381	
281801	Per Impiante dhe makineri	LEK		221,988
281803	Per Pajisje Informative	LEK		125,013

II. Informacione Shpjeguese per DETYRIMET.

Detyrimet e paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **19,790,810 leke** dhe perbehet vetem nga detyrime te periudhave afashkurtra. Detajimi jepet nepermjet informacioneve shpjeguese si vijon;

+ Informacione shpjeguese te DETYRIMEVE AFATSHKURTRA

Detyrimet afatshkurtra jane paraqitur ne total ne vleren **19,790,810 leke**, dhe jane te perbera nga detyrimet ndaj furnitoreve, punonjesve , detyrime ndaj shtetit per tatime dhe taksa.

- Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit ne vleren **14,288,775 leke** paraqesin detyrimin e papaguar per blerjen e mallrave nga furnitore te ndryshem te njesise ekonomike ne fund te vitit 2023.

- Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore ne vleren **4,091,990 leke** perbejne detyrimin per sigurimet shoqerore dhe shendetsore,TAP per muajin Dhjetor 2023 ,paga e shperblime dhe detajohet si vijon;

Elementi	Ref	Vlera
Sigurime Shoqerore	431	230,597
Tatimin mbi te ardhurat personale	442	922,994
Paga Dhe Shperblime	421	2,938,400

- Të pagueshme për detyrimet tatimore ne vleren **1,410,045 leke** perbejne detyrimin per muajin Dhjetor 2023 dhe detajohet si vijon;

Elementi	Ref	Vlera
Shteti- TVSh për tu paguar	4453	1,062,660
Tatimi fitimi	444	347,385

Informacione shpjeguese te DETYRIMEVE AFATGJATA

Detyrimet afatgjata jane paraqitur ne total ne vleren **0 leke**.

III. Informacione Shpjeguese per KAPITALIN

Kapitali i paraqitur ne vleren **12,682,230 leke** dhe eshte i perbere nga zerat Kapital i nenshkuar, Rezerva te tjera, Fitime te Pashperndara dhe Fitim / Humbje e vitit, detajimi i te cilave do te jepet ne informacionet shpjeguese.

1. Informacione shpjeguese te zerit KAPITAL

Ne kete ze jane paraqitur kapitali i kontribuar nga aksionerët ose nga ortakët dhe jane përmbledhur tepricat kreditore të llogarive vijuese:

Emertimi	Ref	Vlera
Kapitali i paguar,	101	3.000.000
Totali		<u>3,000,000</u> leke

Ne perputhje me aktin e themelimit date 21.04.2014 kapitali i kontribuar eshte i perbere nga Kuota ose aksione, gjithsej:

1-Shoq. BigAlbGroup Shpk me nr)aksione 3.000.000 leke qe perben 100 (%) te kapitalit themeltar

2 Informacione shpjeguese te zerit REZERVA TE TJERA

Zeri *Rezerva ligjore* paraqitet ne vleren totale neto **300,000 leke** dhe perfshin rezerven ligjore te njesise ekonomike.

3. Informacione shpjeguese te zerit FITIM / HUMBJE E VITIT

Zeri *Fitim / Humbje e vitit* paraqitet ne vleren **9,382,230 leke** dhe paraqitet rezultati i periudhës rrjedhese ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve pasi eshte zbritur tatimi mbi fitimin.

❖ Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE.

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve eshte paraqitur bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres. Ne kete periudhe ushtrimore ka rezultuar nje fitim ne vleren **9,382,230 leke**.

Zeri Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit te paraqitura ne pasqyre me vleren e tyre neto **149,508,771 leke** evidenton:

Te ardhura nga shitja e Produktit te vet me vleren e tyre neto **145,318,995 leke**.

Te ardhura nga shitja e Shërbimeve me vleren e tyre neto **4,189,766 leke**

Te tjera ne vlere **26,220 leke** nga kembimet valutore.

Zeri Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme te paraqitura ne vleren **121,376,607 leke** perfaqesojne koston e mallrave te blera per qellime rishitje. Politika kontabel eshte paraqitur me larte ne zerin *Mallra per shitje* (Inventar).

Zeri Shpenzime të personelit i cili eshte i paraqitur ne vleren **14,016,015 leke** perfaqeson:

1. Shuma *Paga dhe shpërblime* gjate periudhes ushtrimore 01.01.2023-31.12.2023 ne vleren **12,582,387 leke**
2. Shuma *Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)* gjate periudhes ushtrimore 01.01.2023-31.12.2023 ne vleren **1,433,628 leke**.

Zeri Zhvlersimi i aktiveve afatgjata materiale – i cili eshte i paraqitur me vleren **347,001 leke**, perfaqeson amortizimin e aktiveve afatgjata per periudhen ushtrimore 01.01.2023-31.12.2023

Zeri Shpenzime të tjera shfrytëzimi te cilat jane te paraqitura ne vleren **1,986,197 leke** perfaqesojne shpenzimet te cilat jane kryer per zhvillimin e aktivitetit te njesise ekonomike, dhe perfaqeson zera te shpenzimeve si furnitura, taksa te ndryshme ,diferenca negative dhe pozitive nga kurset e kembimit dhe te tjera.

Zeri Shpenzime të tjera financiare te cilat jane te paraqitura ne vleren **176,550 leke**, perfaqesojne te ardhurat dhe shpenzimet qe vijne nga interesa bankare,

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren CASH FLOW.**

Ne pasqyren e flukseve monetare jane paraqitur flukset hyrese dhe dalese te mjeteve monetare në njësinë ekonomike gjatë periudhës korrente kontabël. Paraqitja eshte bere sipas metodes indirekte.

Gjate periudhes kontabel ka rezultuar;

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit ne vleren **7,061,963 leke**. Fluksi pozitiv ka ardhur pasi flukset dalese te mjeteve monetare per kryerjen e shpenzimeve si psh, paga, detyrime per kontribute te sigurimeve dhe te tatim-taksave jane me te ulta se flukset hyrese te mjeteve monetare gjate ushtrimit normal te aktivitetit nga njesia ekonomike.

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit ne vleren **-219,000 leke** i cili ka ardhur si rezultat i blerjes se aktiveve afatgjate materiale.

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit ne vleren **-7,742,763 leke** i cili ka ardhur si rezultat i dividendit te paguar .

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren NDRYSHIMEVE TE KAPITALIT .**

Ndryshimet ne zerin Kapital kane ardhur si rezultat;

1. Fitim / Humbje e vitit ne vleren **9,382,230 leke**.

Informacionet shpjeguese per zerat e mesiperm jane dhene ne pasqyren e Bilancit.

Drejtuesi

MIRELA SULAJ

Hartuesi

GABRIELA HAXHI